

### Përmbledhje

Norma e rritjes ekonomike për vitin 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së, ishte 3.0 përqind. Kjo rritje vlerësohet të ketë qenë kryesisht rezultat i rritjes së konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht. Në vitin 2014, është shënuar rritje e kreditimit bankar, rritje e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë dhe rritje e remitencave. Në të njëjtën kohë, është shënuar rritje e deficitit tregtar dhe rënie e investimeve publike dhe investimeve të huaja direkte. Rrjedhimisht, norma e rritjes ekonomike prej 3.0 përqind në vitin 2014 ishte më e ulët se sa norma e rritjes prej 3.4 përqind në vitin paraprak. Në vitin 2015, norma reale e rritjes ekonomike pritet të jetë 3.9 përqind.

Spektori bankar gjatë vitit 2014 është karakterizuar me normë më të lartë të rritjes së kredive, të cilat kanë shënuar rritje vjetore prej 4.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat shënuan rritje prej 3.6 përqind krahasuar me rritjen prej 7.5 përqind në vitin paraprak. Spektori bankar ka vazhduar të zvogëlojë normat e interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Mesatarja e normës së interesit në kredi gjatë muajit dhjetor 2014 ishte 9.2 përqind, ndërsa mesatarja e interesit në depozita ishte 1.1 përqind. Spektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej 8.3 përqind në dhjetor 2014, e cila ishte më e ulët se sa norma prej 8.7 përqind në dhjetor 2013. Spektori bankar vazhdon të ketë pozitë të kënaqshme edhe për sa i përket nivelit të kapitalizimit dhe të likuiditetit.

Spektori fiskal u karakterizua me ngritje të lehtë të të hyrave buxhetore, përderisa shpenzimet buxhetore regjistruan nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Përkundër rënies së konsiderueshme të shpenzimeve kapitale, rritja e pagave dhe pensione ka ndikuar që shpenzimet e përgjithshme qeveritare të mbesin në nivel të ngjashëm me vitin e paraprak.

Spektori i jashtëm në vitin 2014 është karakterizuar me rritje të deficitit tregtar prej 2.7 përqind. Gjatë kësaj periudhe, importi i mallrave shënoi rritje vjetore prej 3.6 përqind, ndërsa eksportet u rritën për 10.5 përqind. Shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 12.8 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në vitin 2013. Remitencat kanë vazhduar të përfaqësojnë një burim të qëndrueshëm të të hyrave, duke shënuar rritje të konsiderueshme në nëntë muajt e parë të vitit 2014, ndërsa investimet e huaja direkte kanë shënuar nivel dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak.

Inflacioni ka vazhduar të shënojë rënie. Gjatë vitit 2014, norma mesatare e inflacionit ishte 0.4 përqind krahasuar me normën prej 1.8 përqind në vitin paraprak. Niveli i inflacionit në Kosovë në masë të madhe reflekton lëvizjen e çmimeve të importit, që kryesisht reflektohet nëpërmjet çmimeve të produkteve ushqimore dhe çmimeve të naftës.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b>	<b>04</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b>	<b>06</b>
Sektori Real	06
Sektori Fiskal	09
Sistemi Financiar	10
Sektori Bankar	10
Fondet Pensionale	19
Institucionet Mikrofinanciare	20
Kompanitë e Sigurimit	22
Tregu i Letrave me Vlerë	22
Sektori i Jashtëm	24
<b>GRAFIKËT DHE TABELAT</b>	<b>04</b>
Figura 1. Norma e kreditimit ndër bankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	04
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	05
Figura 3. Çmimi i arit për ounce	05
Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 5. Norma e këmbimit e euros	06
Figura 6. Rritja reale e PBB-së	06
Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje	07
Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve	07
Figura 9. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	08
Figura 10. Regjistri i bizneseve	08
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 12. Asetet e sistemit financiar në Kosovë	10
Figura 13. Asetet e bankave komerciale	10
Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	11
Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive të reja	11
Figura 16. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	12
Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik	12
Figura 18. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik	13
Figura 19. Struktura e maturimit të kredive	13

Figura 20. Struktura e maturimit të kredive të reja -----	13
Figura 21. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale -----	14
Figura 22. Struktura e depozitave në bankat komerciale -----	14
Figura 23. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	15
Figura 24. Struktura e depozitave të afatizuara -----	15
Figura 25. Mesatarja e normave të interesit -----	16
Figura 26. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndermarrjeve -----	16
Figura 27. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare -----	17
Figura 28. Normat mesatare të interesit për depozita -----	17
Figura 29. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale -----	18
Figura 30. Treguesit e profitabilitetit -----	18
Figura 31. NPL-të dhe provizionet për humbje nga kreditë -----	19
Figura 32. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese -----	19
Figura 33. Asetet e institucioneve mikrofinanciale -----	20
Figura 34. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit -----	21
Figura 35. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	23
Figura 36. Norma e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit -----	23
Figura 37. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar -----	21
Figura 38. Remitencat -----	22
Figura 39. Struktura e investimeve të huaja direkte -----	25
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	27

## SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( <i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i> )
CHF	Franku Zvicerran ( <i>angl. Swiss Franc: CHF</i> )
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit ( <i>angl. Consumer Price Index: CPI</i> )
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro ( <i>angl. Euro currency</i> )
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik ( <i>angl. The Pound Sterling</i> )
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit ( <i>angl. Index Price Index: IPI</i> )
NPL	Kreditë Jopërfomuese ( <i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i> )
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete ( <i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i> )
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i> )
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut ( <i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i> )
USD	Dollari Amerikan ( <i>angl. United States Dollar</i> )
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Aktiviteti ekonomik në eurozonë u rikuperua në TM4 2014, duke tejkaluar rrezikun e një rikthimi të recesionit. Megjithatë, rritja e aktivitetit ekonomik në tremujorin e fundit të vitit 2014 ishte e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, kryesisht në Gjermani, përderisa pjesë të ndryshme të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët gjegjësisht rënie ekonomike. Në TM4 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, rritja ekonomike në eurozonë arriti në 0.9 përqind. Megjithëse vazhdon të konsiderohet si një rritje ekonomike modeste, sinjalet për përforsim të mëtejme të aktivitetit në rajonin e eurozonës mbështeten kryesisht në rënien e mëtejme të çmimeve të naftës, gjë që pritet të reflektohet në rritje të besueshmërisë së konsumatorëve dhe rrjedhimisht në rritjen e shpenzimeve. Gjithashtu, rritja e aktivitetit ekonomik pritet të mbështetet nga rritja e vazhdueshme e eksporteve të eurozonës si rezultat i zhvlerësimit të euros si dhe nga fillimi i implementimit të programit të lehtësimit sasior nga Banka Qendrore Evropiane (BQE).

Sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2014 zbriti në 0.4 përqind, nga 1.4 përqind sa ishte në vitin 2013. Rënia e vazhdueshme e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka rezultuar në një deflacion prej 0.6 përqind përkatësisht 0.3 përqind janar dhe shkurt të vitit 2015.

Për të ju kundërvënë rrezikut të ngritur të deflacionit në eurozonë dhe për të rimëkëmbur ekonominë ende

të brishtë në rajon, BQE ka vendosur që të lansojë programin e lehtësimit sasior që nga muaji mars i vitit 2015. Përmes këtij programi, BQE pritet të realizoj blerjen e letrave me vlerë të qeverive evropiane dhe agjencive e institucioneve evropiane në tregjet dytësore. Blerja e letrave me vlerë në sektorin publik dhe privat, në kuadër të këtij programi, pritet të arrijë vlerën prej 60 miliard euro në muaj. Programi i lehtësimit sasior në shkallë të gjerë pritet të zgjatë deri në shtator të vitit 2016.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)


Në dhjetor 2014, BQE mbajti të pandryshuar normën bazë të rifinancimit, gjë që ndikoi në një rritje të lehtë të normave 1 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në dhjetor 2014, normat 1 mujore të Euribor janë ngritur në mesatarisht 0.023 përqind nga 0.018 përqind në shtator 2014. Në anën tjetër, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.33 përqind në dhjetor 2014, nga mesatarja prej 0.36 përqind në shtator 2014.

Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014

përgjithësisht vlerësohet të ketë qenë më e dobët. Maqedonia u karakterizua me rritje të aktivitetit ekonomik gjatë kësaj periudhe, përdërisa Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina si dhe Mali i Zi kishin një aktivitet më të dobët ekonomik përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2014. Serbia ishte vendi i vetëm në rajon që shënoi rënie ekonomike për të dytin tremujor radhazi.

Ngjashëm me vendet e eurozonës, inflacioni në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2014 është karakterizuar me tendencë të dobët të rritjes. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në TM3 2014 ishte 0.5 përqind. Në kuadër të këtyre vendeve, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina u karakterizuan me deflacion.

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD




Burimi: World Bank, EIA (2014), dhe kalkulimet të BQK-së

**Çmimet e naftës (brent crude)**<sup>1</sup> në periudhën janar-dhjetor 2014 shënuan rënie vjetore prej rreth 9.1 përqind (figura 2). Vetëm gjatë TM4 2014 kundrejt tremujorit të njëjtë në vitin paraprak, çmimet e naftës kanë qenë për mesatarisht 30.5 përqind më të ulëta.

<sup>1</sup> 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

Me rënie të çmimit gjatë vitit 2014 u karakterizuan edhe metalet e arit (figura 3). Në vitin 2014, çmimi i arit ishte për rreth 10.3 përqind më i ulët krahasuar me vitin paraprak. Vetëm në TM4 2014 çmimet e arit

Figura 3. Çmimi i arit, në USD për ounce




Burimi: World Bank (2014), Goldman Sachs, Merrill Lynch (2014\*) dhe kalkulime të BQK-së

shënuan një rënie vjetore prej 5.7 përqind.

Mallrat ushqimore në nivel global gjatë vitit 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve krahasuar me vitin paraprak (figura 4).

Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAOUN (2014), Projektionet e FMN-së (2014) të kalkuluar nga BQK

Gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin paraprak, mallrat ushqimore kishin një çmim më të ulët prej mesatarisht 4.2 përqind, përdërisa drithërat kishin çmim më të ulët për mesatarisht 12.5 përqind.

Rënia e çmimeve të drithërave gjatë TM4 2014 kundrejt TM4 2013 ishte rreth 6.6 përqind, përderisa indeksi i përgjithshëm i mallrave ushqimore ishte më i ulët për rreth 7.3 përqind.

**Norma e këmbimit** të euros kundrejt valutave kryesore gjatë TM4 2014 kundrejt TM3 2014 është zhvlerësuar. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro ka shënuar rënie për 0.6 përqind, ndërsa ndaj dollarit amerikan vlera e euros ka shënuar rënie për 5.7 përqind (figura 5).

Figura 5. Norma e këmbimit e euros




Burimi: BQK (2014)

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së, ishte 3.0 përqind (figura 6). Rritja për vitin 2014 bazohet kryesisht në vlerësimet për rritjen e konsumit, ndërsa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë kontribuar negativisht. Për vitin 2015, pritet që ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me përshpejtim të rritjes ekonomike, e cila pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme dhe sidomos nga investimet.

Figura 6. Rritja reale e PBB-së, në përqindje



\* Të dhënat për vitin 2014 dhe 2015 paraqesin vlerësimet dhe parashikimet e BQK-së  
Burimi: ASK (2015)

Të dhënat deri në dhjetor 2014 paraqesin një rritje më të lartë të konsumit, i cili është ndikuar nga rritja e kredive konsumuese, rritja e pagave dhe mëditjeve të sektorit publik, pastaj subvencioneve dhe transfereve, etj. Gjithashtu, rritjen e konsumit e kanë përkrahur edhe remitencat, të cilat deri në shtator 2014 kanë shënuar rritje prej 11.3 përqind. Në anën tjetër, investimet publike në vitin 2014 kanë shënuar rënie prej 22.3 përqind, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte (IHD) deri në shtator kanë shënuar rënie për 44.7 përqind. Rënia e investimeve publike, e cila i atribuohet kryesisht zhvillimeve politike lidhur me formimin e institucioneve, ka bërë që rritja reale e PBB-së të jetë më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Aktiviteti i sektorit privat është përkrahur edhe nga kreditë e sistemit bankar të cilat në fund të vitit 2014 kanë përshpejtuar ritmin e rritjes.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2014 është karakterizuar me normë dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Për dallim nga viti 2013, i cili kishte filluar me normë më të lartë të inflacionit dhe ishte karakterizuar me rënie

të vazhdueshme, viti 2014 ka filluar me normë shumë të ulët të inflacionit, është ngritur gradualisht dhe përsëri ka shënuar rënie në TM4. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2014 ishte 0.4 përqind krahasuar me mesataren prej 1.8 përqind në vitin paraprak (figura 7).

Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2015)

Gjatë vitit 2014, komponentët e CPI-së si pijet alkoolike dhe duhani shënuan rritje për 4.3 përqind, rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse 4.1 përqind dhe veshmbathja 2.8 përqind. Ndërsa, rënie me e theksuar e çmimeve u evidentua tek shërbimet e arsimit për 7.0 përqind dhe shërbimet e transportit për 2.2 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universitetit publik, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Çmimet e produkteve të ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rënie prej 0.2 përqind (figura 8). Pavarësisht që shënuan rënie të lehtë të çmimit, produktet e ushqimit paraqesin një rën timer ndërkategoritë më me ndikim në zvogëlim e inflacionit

duke qenë se përfaqësojnë rreth 37.8 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.


Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2015)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 9).

Figura 9. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2015)

Mesatarja e çmimeve të importit deri në shtator 2014 shënoi rënie prej 0.6 përqind (0.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2013). Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë me 21.6 përkatësisht 20.9 përqind, pasuar nga metalet bazë




me 12.2 përqind, ndërsa çmimet e tekstilit kanë shënuar rënie më të lartë të çmimeve me 24.1 përqind pasuar nga artikujt ushqimor me 7.2 përqind.

Indeksi i çmimeve të prodhimit deri në shtator 2014 shënoi rritje mesatare vjetore prej 0.8 përqind ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kishte shënuar rritje prej 3.1 përqind. Rritja e çmimeve ishte më e theksuar tek prodhimi i produkteve kimike me 34.5 përqind dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të tij me 11.4 përqind. Në anën tjetër, rënie e çmimeve të prodhimit më së shumti u shënuar tek nxjerrja e xehes së metalit me 16.3 përqind, pasuar nga rënia e çmimeve të prodhimit të pajisjeve elektrike me 15.9 përqind, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës me 9.4 përqind, etj.

Gjatë vitit 2014 u regjistruan 9,404 ndërmarrje të reja apo 16 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1,671 biznese apo 163 biznese më shumë se sa në vitin paraprak (figura 10).

Figura 10. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2015)

Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar ku dominojnë tregtia,

hoteleria, prodhimi, ndërtimtaria dhe bujqësia (figura 11). Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar rënie e numrit të bizneseve të regjistruara tek ndërmarrjet me aktivitete të patundshmërisë prej 198 ndërmarrjesh dhe ndërtimtarisë me 140 ndërmarrje më pak të regjistruara, ndërsa hoteleria dhe prodhimi kanë shënuar rritje për 123 përkatësisht 106 ndërmarrje. Rritje kanë shënuar edhe ndërmarrjet e regjistruara në tregti.

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2015)

### Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore në vitin 2014 arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro që është për 1.5 përqind më shumë se sa në vitin paraprak. Ky nivel më i lartë i të hyrave është arritur përkundër faktit se në vitin 2014 janë arkëtuar vetëm 15.0 milionë euro të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në vitin e kaluar ishin realizuar 43.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda, atëherë të hyrat buxhetore në vitin 2014 shënuan rritje prej 3.8 përqind. Shpenzimet primare buxhetore në vitin 2014 arritën vlerën prej 1.5 miliardë euro që paraqet nivel



të ngjashëm me vitin paraprak. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej rreth 131 milionë euro (2.4 përqind e PBB-së) krahasuar me deficitin primar prej rreth 150 milionë euro të shënuar në vitin paraprak (2.9 përqind e PBB-së).

Ekzekutimi i shpenzimeve të planifikuara në vitin 2014 ishte pothuajse i njëjtë krahasuar me vitin paraprak (91 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel më të mirë të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan vetëm në masën prej 80.0 përqind të planit krahasuar me shkallën prej 84.4 përqind të realizimit në vitin paraprak. Në anën tjetër, realizimi i të hyrave buxhetore arriti nivelin prej 90.9 përqind të planit për vitin 2014, që është për 1.4 pikë përqindje më i ulët se sa në vitin paraprak.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura në kufi të cilat shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind dhe arritën nivelin neto prej 868.6 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën neto prej 272.6 milionë euro që janë për 0.7 përqind më të larta se sa në vitin paraprak. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 46.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 8.0 përqind. Gjithashtu, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rritje për 3.4 përqind duke arritur vlerën prej 98.2 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve, pagat e mëditjet dhe subvencionet e transferet shënuan rritje krahasuar me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet kapitale dhe mallrat e shërbimet shënuan rënie. Investimet

kapitale, të cilat në vitin 2014 përfaqësuan rreth 28.1 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan vlerën prej 411.4 milionë euro që paraqet rënie prej 22.3 përqind. Zvogëlimi i investimeve kapitale i adresohet përfundimit të projektit të autostradës R-7, e cila në vitin paraprak ka qenë në implementim e sipër. Përveç përfundimit të projektit të autostradës R-7, vonesa në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve të qershorit 2014 ndikuan në shtyrjen e realizimit të një pjese të projekteve kapitale. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rënie për 3.6 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 205.8 milionë euro. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 17.3 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 485.2 milionë euro, që është kryesisht rezultat i vendimit të qeverisë për ngritjen e pagave. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 15.4 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 361.2 milionë euro.


Borxhi publik, në fund të vitit 2014, ka arritur në 582.9 milionë euro nga 476.3 milionë euro sa ishte në vitin paraprak, ndërsa si përqindje e PBB-së ka arritur në 10.6 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në vitin paraprak. Kjo rritje prej 22.4 përqind e borxhit publik, i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm ndërkohë që borxhi i jashtëm ka mbetur pothuajse i pandryshuar.

### **Sistemi Financiar**

Në dhjetor 2014, vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 4.54 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.4 përqind. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes së asetëve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale.

Sektori i sigurimeve, pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishte kontribut të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit. Ndërsa, asetet e sektorit

Figura 12. Asetet e sistemit financiar të Kosovës, në përqindje (dhjetor 2014)



Burimi: BQK (2015)


mikrofinanciar dhe ndihmësve financiar kishin kontribut pothuajse neutral në rritjen e gjithsej asetëve. (figura 12).

## Sektori Bankar

### Asetet

Vlera e gjithsej asetëve të sektorit bankar në dhjetor 2014 arriti në 3.18 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.2 përqind (figura 13). Gjatë vitit 2014 ritmi i rritjes së aktivitetit bankar është ngadalësuar krahasuar me rritjen e përsheptuar të shënuar në vitin e mëparshëm. Kjo ishte rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave të cilat edhe janë burimi kryesor i financimit të bankave. Depozitat gjatë vitit 2014 u karakterizuan me normën më të ulët të rritjes që nga fillimi i operimit të sektorit bankar të Kosovës, kryesisht si rrjedhojë e rënies të theksuar të normave të interesit në depozita.

Figura 13. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Struktura e asetëve të sektorit bankar, në përgjithësi, mbetet e ngjashme me vitin paraprak. Gjatë vitit 2014 vërehet një rritje e lehtë pjesëmarrjes së kategorive të bilancit me bankat tjera, letrave me vlerë, dhe kredive në gjithsej asetet e bankave, ndërsa kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK shënoi zvogëlim. Kjo lëvizje tregon për zhvendosjen e mjeteve drejt kategorive më të rëndësishme siç janë kreditimi dhe letrat me vlerë.


Vlen të theksohet se gjatë vitit 2014, pavarësisht ngadalësimit të rritjes së gjithsej asetëve, aktiviteti kreditues ka përsheptuar ritmin e rritjes duke u rimëkëmbur nga rritja e ngadalshme e viteve të fundit. Për dallim nga kreditë, kategoritë e letrave me vlerë dhe bilancit me bankat tjera shënuan ngadalësim të rritjes gjatë vitit 2014, ndërsa paraja e gatshme dhe bilanci me BQK shënuan rënie.

Investimet në letra me vlerë, në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 383.8 milionë, duke shënuar rritje vjetore prej 8.3 përqind, dukshëm më të ulët se rritja prej 38.2 përqind e vitit paraprak. Në kuadër të investimeve në letra me vlerë, gjatë vitit 2014, bankat u orientuan më shumë në investime në letrat me vlerë

të qeverisë së Kosovës, të cilat përbënin 50.2 përqind të gjithsej portfolios së investimeve nga 28.2 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, investimet në letrat me vlerë të qeverive të huaja kanë pësuar rënie në portfolion e investimeve për 22.0 pikë përqindje, duke arritur kështu në 49.7 përqind. Kjo zhvendosje drejt investimeve në vend ishte kryesisht rezultat i normave më të larta të interesit në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës krahasuar me vitin paraprak dhe me normat e interesit në letrat me vlerë të qeverive të huaja. Kategoria tjetër që u karakterizua me rritje të ngadalësuar ishte bilanci me bankat tjera që gjatë vitit 2014 shënoi rritje prej 15.0 përqind krahasuar me rritjen prej 18.1 përqind gjatë vitit 2013.

Kategoria e vetme që u karakterizua rënie gjatë vitit 2014 ishte paraaja e gatshme dhe bilanci me BQK që shënoi rënie vjetore prej 3.5 përqind krahasuar me rritjen prej 8.8 përqind të vitit paraprak. Kjo rënie i atribuohet kryesisht zvogëlimit të rezervave të aseteve të mbajtura mbi shumën e obliguar.

Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


### Kreditë

Kategoria kryesore e aseteve të sektorit bankar kreditimi gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje të përshpejtuar krahasuar me vitin paraprak.

Në dhjetor 2014, gjithsej kreditë arritën vlerën 1.88 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.2 përqind (2.4 përqind në vitin 2013) (figura 14).

Kreditë e reja të lëshuara në vitin 2014 arritën vlerën prej 993.9 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 30.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 2.4 përqind në vitin 2013 (figura 15). Kjo sugjeron që rimëkëmbja e aktivitetit kreditues do të vazhdoj edhe gjatë vitit në

Figura 15. Vlera dhe ndryshimi vjetor i kredive të reja, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

vijim.

Në kuadër të gjithsej kredive aktive, kreditë për ekonominë familjare shënuan rritje të përshpejtuar prej 12.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.9 përqind në dhjetor 2013. Sidoqoftë, përshpejtimi i rritjes nuk vërehet edhe te kreditë për ndërmarrjet të cilat shënuan normë të ngjashme të rritjes krahasuar me vitin e kaluar. Kreditë për ndërmarrje, në dhjetor

2014, shënuan rritje prej 2.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 2.0 përqind në dhjetor 2013 (figura 16).


Figura 16. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket kredive për ekonomitë familjare rritja e përshpejtuar ishte rezultat i rritjes së pagave për shërbyesit civil në njërën anë si dhe presioneve të konkurrencës në lehtësimin deri në një masë të standardeve kreditore, në anën tjetër. Kurse, në raport me kreditë për ndërmarrjet kërkesa në përgjithësi ishte më e lartë, mirëpo jo dhe aq nga ndërmarrjet e mëdha.<sup>2</sup>

Figura 17. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (dhjetor 2014)



Burimi: BQK (2015)


Kjo ndikoi që pavarësisht lehtësimit të standardeve kreditore për ndërmarrje, rritja vjetore për këtë kategori të mbetet e ngjashme me vitin e kaluar.

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike, vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për tregti me pjesëmarrje prej 53.4 përqind, pasuar nga prodhimtaria me 12.0 përqind dhe ndërtimtaria me 8.4 përqind. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë çasje më të ulët në financimin bankar, me pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (figura 17).

Gjatë vitit 2014, kreditimi i ndërmarrjeve në raport me të gjithë sektorët ekonomik shënoi rritje, me përjashtim të sektorit të ndërtimtarisë i cili thelloi rënien. Në dhjetor 2014, kreditë për prodhimtari u karakterizuan me rritjen më të theksuar vjetore prej 13.1 përqind, pasuar nga kreditë për bujqësi dhe tregti që shënuan rritje prej 7.9 përqind përkatësisht 3.6 përqind. Ndërsa, kreditë për ndërtimtari u karakterizuan me rënie vjetore prej 12.2 përqind (figura 18). Faktori kryesor në rritjen e kreditimit të pothuajse të gjithë sektorëve ekonomik mund të jetë rënia e mesatares vjetore të normave të interesit për kreditë industriale, bujqësore, dhe për shërbime gjatë vitit 2014.

<sup>2</sup> Bazuar në rezultatet e anketës për kreditimin bankar për Dhjetor 2014.


Figura 18. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2015)

Sipas maturitetit, struktura e gjithsej kredive vazhdon të dominohet nga kreditë ‘mbi 1 deri në 5 vite’ edhe gjatë vitit 2014 (figura 19). Krahasuar me vitin paraprak, në dhjetor 2014 vihet re një rritje e pjesëmarrjes së kredive afatgjata ‘mbi 5 vite’ ndërsa zvogëlim i atyre me afat më të shkurtër maturimi ‘deri në 1 vit’.

Figura 19. Struktura e maturimit të kredive




Burimi: BQK (2015)

Kjo zhvendoje drejt kredive afatgjata, është më e theksuar te struktura e kredive të reja. Gjatë vitit 2014, kreditë “mbi 5 vite” zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë e reja në 24.2 përqind nga 15.8 përqind në vitin paraprak. Lëvizja tjetër më e theksuar në strukturën e kredive të reja është zvogëlimi i theksuar i pjesëmarrjes së kredive

afatmesme ‘mbi 1 deri në 5 vite’ në 65.2 përqind krahasuar me vitet paraprake (figura 20).

Figura 20. Struktura e maturimit të kredive të reja



Burimi: BQK (2015)

Gjatë vitit 2014, asetet e sektorit bankar u karakterizuan me rritje të ngadalsuar krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si rezultat i ngadalsimit të theksuar të depozitave që janë edhe burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Megjithatë, kreditimi si kategoria më e rëndësishme e asetëve të sektorit shënoi përshpejtim të rritjes gjatë vitit 2014.

### Detyrimet


Gjatë vitit 2014, struktura e detyrimeve të sektorit bankar të Kosovës vazhdoi të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturën e gjithsej detyrimeve mbetet ajo e mjeteve vetanake të cilat në dhjetor 2014 arritën vlerën 323.1 milionë duke shënuar rritjen më të theksuar në kuadër të gjithsej detyrimeve prej 16.3 përqind (2.6 përqind në dhjetor 2013). Faktori kryesor në rritjen e përshpejtuar të mjeteve vetanake krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është rritja e theksuar e profitit të akumuluar të gjithsej sektorit bankar gjatë vitit 2014.

Kategoria tjetër e detyrimeve, borxhi i ndërvarur, deri në dhjetor 2014, ka arritur vlerën 47.3 milionë duke shënuar rënie prej 16.0 përqind krahasuar me rritjen e theksuar prej 81.5 përqind që u shënuua në dhjetor 2013. Rritja e theksuar në vitin paraprak ishte rrjedhojë e plotësimit të kërkesave të reja rregullative. Duke marrë parasysh që bankat kanë siguruar pajtueshmërinë me kërkesat rregullative ato gjatë vitit 2014, kanë zvogëluar borxhin e ndërvarur.

### Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar në dhjetor 2014 arritën vlerën 2.53 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 3.6 përqind. Kjo rritje ishte dukshëm më e ulët krahasuar me vitet paraprake (figura 21). Faktori kryesor që mund të ketë ndikuar ngadalësimin e rritjes në depozita cilësohet rënia e theksuar e normës së interesit në depozita gjatë vitit

Figura 21. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

2014. Zvogëlimi i theksuar i normës së interesit në depozita në prezencë të likuiditetit të mjaftuar, gjatë vitit 2014, sugjeron orientimin e bankave në rritjen e margjinës së profitit në vend të rritjes së metutjshme

të bazës së depozitave.

Figura 22. Struktura e depozitave në bankat komerciale



Burimi: BQK (2015)


Struktura e depozitave në sektorin bankar vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare, të cilat përbëjnë 72.8 përqind të gjithsej depozitave. Kategoria e dytë për nga pesha në strukturë është ajo e depozitave të ndërmarrjeve që kanë një pjesëmarrje prej 22.1 përqind. Ndërsa, depozitat tjera mbesin kategoria më e vogël me pjesëmarrje prej 5.1 përqind në gjithsej depozitat e sektorit bankar (figura 22).

Dy kategoritë kryesore: depozitat e ekonomive familjare dhe ato të ndërmarrjeve u karakterizuan me rritje të ngadalësuar vjetore krahasuar me vitin paraprak. Në dhjetor 2014, depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 4.1 përqind (8.2 përqind në dhjetor 2013), ndërsa depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej vetëm 0.7 përqind (5.4 përqind në dhjetor 2013). Rritja e ngadalësuar e përkon me rënien e theksuar të normës së interesit në të dy kategoritë e depozitave krahasuar me vitin e kaluar. Kategoria e depozitave tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare etj.) shënoi rritje vjetore prej 9.4 përqind në dhjetor 2014 (6.2 përqind në dhjetor 2013).



Struktura e depozitave sipas maturitetit ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2014 në krahasim me vitin paraprak kur struktura e depozitave dominohej nga depozitat e afatizuara. Në dhjetor 2014 pjesa më e madhe e depozitave ishin në formë të depozitave të transferueshme, të cilat përbënë 47.2 përqind të gjithëj depozitave. Depozitat e afatizuara përbënë 31.7 përqind ndërsa ato të kursimit 16.5 përqind (figura 23).


Figura 23. Struktura depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Zvogëlimi i theksuar i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në strukturën e gjithëj depozitave mund të jetë ndikuar nga rënia e theksuar e normave të interesit në depozita, gjë që mund të ketë dekurajuar afatizimin e depozitave nga depozituesit.

Figura 24. Struktura e depozitave të afatizuara



Burimi: BQK (2015)


Në kuadër të strukturës së depozitave të afatizuara, në periudhën raportuese vihet re ndërprerja e trendit rritës i ndjekur gjatë tri viteve paraprake i depozitave afatshkurta ‘deri 1 vit’. Ndërsa, depozitat afatmesme dhe afatgjate u karakterizuan me rritje të pjesëmarrjes në strukturën e depozitave të afatizuara (figura 24).

Gjatë vitit 2014, depozitat të cilat edhe paraqesin burimin kryesor të financimit u karakterizuan me normën dukshëm më të ulët të rritjes krahasuar me me vitin paraprak. Ky ngadalsim kryesisht mund t'i atribuohet rënies së theksuar të normës së interesit në depozita gjatë kësaj periudhe. Borxhi i ndërruarur shënoi rënie, përderisa mjetet vetanake përshpejtuan trendin e rritjes duke reflektuar kështu rritjen e theksuar të profitit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe.

### Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita edhe gjatë vitit 2014, kanë vazhduar trendin rënës.

Figura 25. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Në dhjetor 2014, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 9.2 përqind, krahasuar me 11.1 përqind në dhjetor 2013. Në depozita, norma mesatare e interesit u zvogëlua në 1.1 përqind në dhjetor 2014, nga 2.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.




Rënia e theksuar e normës së interesit në kredi u ndikua kryesisht nga presioni i konkurrencës si rezultat i të cilit bankat lehtësuan standardet kreditore. Kontribues në rënie ishte edhe zvogëlimi i kostos së financimit të aktivitetit kreditues si rrjedhojë e uljes së konsiderueshme të normave të interesit në depozita. Ndërsa rënia e normës së interesit në depozita ishte rezultat i orientimit të strategjisë së bankave drejt rritjes së marginës së profitit krahas rritjes së bazës së depozitave në prezencë të likuiditetit të mjaftueshëm. Megjithatë, vlen të ceket që nga qershor 2014 vërehet një tendencë e rritjes së normave të interesit në depozita. (figura 25).

Rrjedhimisht, në dhjetor 2014, dallimi në mes të normës së interesit në kredi dhe depozita u zvogëlua në 8.1 përqind nga 8.7 përqind në dhjetor 2013, rezultat i rënies së normave të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita (figura 25).

Gjatë vitit 2014, trendi i rënies së normave të interesit në kredi është shprehur si te kreditë për

Figura 26. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

ndërmarrje, ashtu edhe te ato për ekonomitë familjare. Norma mesatare e interesit te kreditë për

ndërmarrje në dhjetor 2014 u zvogëlua në 9.4 përqind nga 10.9 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, rënia më e theksuar u shënua te kreditë jo-investuese me maturim 'deri në 1 vit', të cilat në dhjetor 2014 zbritën në 9.5 përqind nga 11.6 përqind në dhjetor 2013. Po ashtu, normat e interesit në kreditë investuese me maturim 'deri në 1 vit' u zvogëluan në 10.8 përqind nga 12.3 përqind sa ishin në dhjetor 2013 (figura 26).

Sipas veprimtarisë ekonomike, rënia e normës së interesit ishte më e theksuar te kreditë për sektorët e bujqësisë dhe industrisë. Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit të bujqësisë u zvogëlua në 12.6 përqind në dhjetor 2014 nga 15.0 përqind në dhjetor 2013, ndërsa për sektorin e industrisë u zvogëlua në 8.9 përqind nga 11.0 përqind në dhjetor 2013. Për sektorin e shërbimeve, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluan në 9.9 përqind në dhjetor 2014 nga 10.9 në dhjetor 2013.

Figura 27. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind




Burimi: BQK (2015)

Në dhjetor 2014, norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare u zvogëlua në 9.0 përqind, nga 11.4 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit për

kreditë konsumuese shënuan rënien më të madhe, në 9.1 përqind në dhjetor 2014 (11.7 përqind në dhjetor 2013), përderisa në kreditë hipotekare u zvogëlua në 8.2 përqind (9.7 përqind në dhjetor 2013) (figura 27).

Figura 28. Normat mesatare të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Sa i përket normave të interesit në depozita, vërehet një rënie e theksuar e interesit për depozitat e ekonomive familjare nga 2.8 përqind në dhjetor 2013 në 0.9 përqind në dhjetor 2014 (figura 28).

Kurse, te ndërmarrjet, norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në 1.9 përqind në dhjetor 2014 nga 1.2 përqind sa ishte në dhjetor 2013.

### **Performanca e sektorit bankar**

Sektori bankar i Kosovës shënoi rritje të theksuar të profitit gjatë vitit 2014. Neto profiti i realizuar gjatë këtij viti shënoi vlerën 60.1 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 26.0 milionë në vitin 2013. Rritja e profitit gjatë vitit 2014 erdhi si rezultat i menaxhimit më të mirë të shpenzimeve, që shënuan rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar, përderisa të hyrat shënuan rënie të lehtë.


Gjithsej shpenzimet e sektorit bankar deri në dhjetor 2014 arritën vlerën në 184.2 milionë euro, e cila është për 17.4 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve u shkaktua kryesisht nga reduktimi i shpenzimeve të jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 43.0 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, rënien më të madhe e shënuan shpenzimet për provizione, të cilat u reduktuan për 55.4 përqind në krahasim me vitin paraprak. Ndarja më e ulët e provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë mund të jetë rezultat i rënies së vlerës së gjithsej kredive jo performuese. Gjithashtu, në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve ndikoi edhe reduktimi i shpenzimeve të interesit që shënuan rënie vjetore prej 31.1 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita shënuan rënie vjetore prej 37.3 përqind, gjë që kryesisht reflekton zvogëlimin e normës së interesit në depozita, por poashtu mund të reflektojë edhe rritjen më të ngadalshme të depozitave në fund të vitit 2014.

Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, u karakterizuan me një rritje vjetore prej 1.2 përqind deri në dhjetor 2014, që nënkupton se zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit bankar nuk është shumë i lidhur me përmirësimin e efikasitetit operacional.

Të hyrat e sektorit bankar deri në dhjetor 2014 arritën vlerën 244.2 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.9 përqind. Zvogëlimi i të hyrave ishte rezultat i zvogëlimit të dy kategorive kryesore të të hyrave: ato nga interesi që dominojnë gjithsej të hyrat

më 80.2 përqind dhe atyre nga jo-interesi që përbëjnë 19.6 përqind të gjithsej të hyrave.

Figura 29. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2015)

Në dhjetor 2014, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind. Ky zvogëlim në arkëtimin e të hyrave kryesisht i atribuohet rënies së të hyrave nga interesi në kredi, që ndër tjerash u ndikuan nga normat më të ulëta të interesit gjatë vitit 2014 krahasuar me vitet e kaluara. Të hyrat nga jo-interesi në dhjetor 2014 shënuan rënie vjetore prej 3.6 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht pasojë e rënies së të hyrave nga tarifat dhe komisionet pavarësisht shtrenjtimit të shërbimeve bankare, si dhe të ardhurave tjera operative (që kanë një përfaqësim të vogël në gjithsej të hyrat) me 2.6 përqind përkatësisht 15.1 përqind. Rënia në të ardhurat nga tarifat dhe komisionet pavarësisht shtrenjtimit të shërbimeve bankare mund të reflektoj rritjen e numrit dhe vëllimit të transaksioneve e-banking që kanë tarifa më të ulëta krahasuar me shërbimet që ofrohen në filialet e bankave.

Rënia e lehtë në të hyrat krahasuar me zvogëlimin e theksuar të shpenzimeve ka ndikuar që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar të përmirësohet dukshëm duke u zvogëluar në 75.4 përqind në dhjetor 2014, krahasuar 89.6 përqind sa ishte në dhjetor 2013 (figura 29). Po ashtu, profiti i realizuar gjatë vitit 2014 ka ndikuar që Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) të përmirësohet në 1.9 përqind, nga 0.9 përqind sa ishte në 2013, përdërisa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 20.2 përqind, nga 9.4 përqind sa ishte në 2013 (figura 30).


Figura 30. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2015)

Sektori bankar shënoi rritje të theksuar të profitit, përkundër rënies së lehtë të të hyrave. Rritja e profitit ishte rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizione për humbje të mundshme nga kreditë si dhe shpenzimeve të interesit në depozita.

Figura 31. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Në dhjetor 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 8.3 përqind nga 8.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 31).

Në dhjetor 2014, shuma e kredive jo performuese shënoi rënie vjetore prej 0.2 përqind krahasuar me

Figura 32. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

rritjen prej 18.6 përqind në dhjetor 2013 (figura 32).

Rritja e përshpejtuar e kreditimit krahasuar me vitin e kaluar (ndikuar nga rritja rekorde e kredive të reja) si dhe rritja e pagave në sektorin publik, mund të kenë pasur efekt pozitiv në uljen e normës dhe vlerës së kredive jo performuese në vitin 2014 krahasuar me

2013. Për më tepër kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Në dhjetor 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 114.4 përqind (110.5 përqind në dhjetor 2013).

Po ashtu, sektori bankar ka përforcuar edhe më shumë nivelin e kapitalizimit, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 17.8 përqind në dhjetor 2014 nga 16.7 përqind sa ishte në dhjetor 2013. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet përmirësimit të performancës së sektorit bankar si rezultat i rritjes së profitit dhe kapitalit nga aksionarët.

Sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2014 sikur edhe viteve të kaluara ka vazhduar të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në dhjetor 2014, raporti i kredive ndaj depozitave arriti në 74.2 përqind nga 73.7 përqind në dhjetor 2013. Për më tepër, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 43.3 përqind në dhjetor 2014.<sup>3</sup>

### Fondet pensionale

Asetet e sektorit pensional në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 1.09 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 19.1 përqind. Struktura e aseteve të sektorit të pensioneve dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) i cili menaxhon 99.5 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa pjesa e mbetur prej 0.5 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno–Kosovar i Pensioneve (FSKP).

FKPK gjatë vitit 2014 ka vazhduar të zgjerohet si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe arkëtimeve

<sup>3</sup> Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.

të reja të kontributeve pensionale. Gjithsej asetet e FKPK-së në dhjetor 2014 arritën vlerën prej 1.1 miliard euro. Gjatë vitit 2014, FKPK ka realizuar 66.7 milionë euro kthim bruto nga investimet. Në ditën e fundit të dhjetorit 2014, çmimi i aksionit arriti në 1.29 euro (1.21 euro në dhjetor 2013). Ndërsa, vlera e kontributeve të arkëtuara deri në dhjetor 2014 arriti në 128.8 milionë euro me rreth 476.6 mijë kontribues.

Performancë pozitive është vërejtur edhe në aktivitetin e FSKP-së. Në dhjetor 2014, gjithsej asetet e FSKP-së kishin vlerën 5.8 milionë euro krahasuar me 5.3 milionë euro sa ishin në dhjetor 2013. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që deri në dhjetor 2014 arriti në 371.9 mijë euro. Në ditën e fundit të dhjetorit 2014, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.16 euro (129.97 euro në dhjetor 2013).<sup>4</sup>


### **Institucionet mikrofinanciare (IMF)**

Sektori mikrofinanciar gjatë vitit 2014 ka ndërprerë trendin e tkurrjes së aktivitetit të ndjekur gjatë viteve të fundit.

Në dhjetor 2014, vlera e gjithsej asetëve të institucioneve mikrofinanciare arriti në 112.9 milionë euro (figura 33).

Institucionet mikrofinanciare u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues dhe të lizingjeve. Në dhjetor 2014, vlera e gjithsej kredive arriti në 74.4 milionë euro, rritje vjetore prej 2.9 përqind (rënie vjetore prej 6.7 përqind në vitin e kaluar).

Figura 33. Asetet e institucioneve mikrofinanciare dhe rritja vjetore



Burimi: BQK (2015)

Rritja e kreditimit gjatë vitit 2014 ishte rezultat i zgjerimit të aktivitetit kreditues për biznese, kurse kreditë për ekonomitë familjare u karakterizuan me rënie të lehtë. Në dhjetor 2014, kreditë për biznese shënuan rritje vjetore prej 10.0 përqind, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rënie vjetore prej 0.4 përqind. Rënia vjetore e kredive për ekonomitë familjare mund të jetë ndikuar nga konkurrenca prej sektorit bankar duke marrë parasysh që kreditimi bankar i ekonomive familjare gjatë të njëjtës periudhë u karakterizua me rritje të përshpejtuar.


Sipas sektorëve ekonomik, të gjitha kategoritë e kreditimit gjatë vitit 2014, u karakterizuan me rritje. Kreditë për sektorin e shërbimeve të cilat përbëjnë 46.5 përqind të gjithsej strukturës, u karakterizuan me rritje vjetore prej 10.6 përqind në dhjetor 2014 (rënie vjetore prej 14.4 përqind në dhjetor 2013). Kreditë për sektorin e industrisë, të cilat janë kategoria e dytë nga pesha në strukturë, shënuan rritjen më të theksuar vjetore prej 15.3 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me rënie vjetore prej 16.7 përqind në dhjetor 2013. Lëvizje të ngjajshme shënuan edhe kategoria e tretë: kreditë për bujqësi të

<sup>4</sup> Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.6 përqind në dhjetor 2014 (rënie prej 22.6 përqind në dhjetor 2013).

Struktura e kredive të IMF-ve sipas maturitetit vazhdon të jetë e ngjashme me vitet e kaluara, duke u dominuar nga kreditë me afat të mesëm maturimi, pasuar nga ato me afat të shkurtër maturimi. Ndërsa, kreditë afatgjata vazhdojnë të kenë përfaqësim të ulët. Kreditë me afat maturimi ‘mbi 1 deri 5 vite’ në dhjetor 2014 kishin një pjesëmarrje prej 86.3 përqind në gjithsej kreditë, pasuar nga ato me maturim ‘deri 1 vit’ me 13.4 përqind dhe ‘mbi 5 vite’ me 0.4 përqind (figura 34).

Figura 34. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)

Vlera e lizingjeve në dhjetor 2014 arriti në 22.4 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 1.4 përqind (rritje vjetore prej 6.0 përqind në dhjetor 2013). Lizingjet për ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore prej 97.6 përqind në dhjetor 2014 kryesisht rezultat i rritjes së lizingut hipotekar në 11.0 milionë euro nga 5.2 milionë sa ishte në vitin e kaluar. Ndërsa, lizingjet për biznese shënuan rënie vjetore prej 34.9 përqind në dhjetor 2014 kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të lizingut hipotekar dhe atij për blerjen e pajisjeve.

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me norma të larta të interesit në kredi. Mesatarja e normës efektive të interesit për kreditë e lëshuara nga ky sektor në dhjetor 2014 ishte 23.3 përqind (22.6 përqind në dhjetor 2013). Mesatarja e interesit në kredi për ndërmarrje në dhjetor 2014 ishte 22.6 përqind (19.8 përqind në dhjetor 2013), kurse për kreditë e ekonomive familjare norma mesatare ishte 23.8 përqind (23.7 përqind në dhjetor 2013).

Në kuadër të kredive për ndërmarrje, norma mesatare e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë dhe të shërbimeve në dhjetor 2014 u rrit në 25.5 përqind përkatësisht 21.7 përqind (25.0 përqind përkatësisht 20.4 përqind në dhjetor 2013). Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit të industrisë u zvogëlua në 23.8 përqind nga 25.3 përqind në dhjetor 2013. Zvogëlimi i normave të interesit për sektorin e bujqësisë dhe të industrisë mund të ketë ndikuar në rritjen e theksuar të kreditimit për këto dy kategori krahasuar me vitin e kaluar.

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel relativisht të ulët të kredive jo performuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kësaj kategorie të kredive. Në dhjetor 2014, niveli i kredive jo performuese në gjithsej kreditë ishte 4.8 përqind, që paraqet një rënie nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur ky raport qëndronte në 5.2 përqind. Gjithashtu, edhe mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione u përmirësua në 113.1 përqind në dhjetor 2014 krahasuar me nivelin prej 107.0 përqind në dhjetor 2013.



Deri në dhjetor 2014, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra prej 19.3 milionë euro, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rritje prej 0.6 përqind (rënie prej 7.5 përqind deri në dhjetor 2013). Kurse, shpenzimet shënuan rënie vjetore prej 7.7 përqind kryesisht si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë dhe reduktimit të shpenzimeve për personelin. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve deri në dhjetor 2014 u zvogëlua në 18.0 milionë euro, dhe rezultoi në profit neto prej 1.3 milionë euro kundrejt humbjeve prej 0.3 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Operimi me fitim në vitin 2014 ndikoi në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 1.1 përqind (-0.3 përqind në vitin 2013), ndërsa ROAE u përmirësua në 4.3 përqind (-1.1 përqind në vitin 2013).

### **Kompanitë e sigurimit**

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në dhjetor 2014 shënuan rritje vjetore prej 5.8 përqind, duke arritur vlerën 140.4 milionë euro. Në kuadër të gjithsej asetëve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 126.3 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 14.1 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 82.0 milionë euro, që krahasuar me dhjetor 2013 paraqet një rritje prej 3.7 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 79.6 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë 2.4 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në dhjetor 2014 arriti në 33.4 milionë euro, prej të cilave 19.1 milionë euro

janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësive ndaj palës së tretë.

Deri në dhjetor 2014, sektori i sigurimeve regjistroi humbje në vlerë prej 318.8 mijë euro, krahasuar me humbjet prej 754.6 mijë euro vitin e kaluar. Sigurimi jo-jetë vazhdon të karakterizohet me humbje krahasuar me sigurimin jetë që rezultoi me performancë të mirë financiare. Deri në dhjetor 2014, sigurimi jo-jetë kishte humbje prej 806.3 mijë euro krahasuar me humbjet prej 1.0 milionë euro gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Sigurimi jetë u karakterizua me rritje të profitit në 487.5 mijë euro nga 287.4 mijë euro fitim në vitin e kaluar.

Zvogëlimi i humbjeve pati ndikim edhe në indikatorët e profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në -0.23 përqind (-0.26 përqind në vitin 2013) kurse ROAE u përmirësua në -0.68 përqind (-0.74 përqind në vitin 2013).

---

*Sektori pensional vazhdoi të ketë performancë të mirë financiare dhe zgjerim të aktivitetit. Sektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe zvogëlim të humbjeve. Kurse, sektori mikrofinanciar regjistroi nivel të ngjashëm të asetëve me vitin paraprak, përderisa performanca financiare e sektorit u përmirësua.*

---

### **Tregu i Letrave me vlerë**


Tregu i letrave me vlerë ka vazhduar të jetë mjaft tërheqës për akterët primarë edhe në vitin 2014. Kjo u evidentua te rritja e investimeve të bankave komerciale, në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës krahas zvogëlimit të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja. Mirëpo, gjatë vitit edhe Fondi i



Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) ka rritur investimet në letrat me vlerë krahasuar me vitin paraprak. Gjatë periudhës janar-dhjetor, qeveria e Kosovës ka plotësuar nevojat për financim të aktiviteteve të saj duke e zgjeruar vëllimin e emetimit të letrave me vlerë në 397.0 milionë euro (308.2 milionë në vitin paraprak).

Në vitin 2014, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka pasur gjithsej 21 ankande. Prej të cilave, 4 me afat maturimi 91 ditë, 7 me afat maturimi 182 ditë, 6 me afat maturimi 364 ditë, si dhe 4 ankande me afat maturimi dy vjeçar. Krahasuar me vitin e kaluar, kemi një zhvendosje të emetimit të letrave me vlerë afatshkurtra në drejtim të atyre afatgjata (figura 35). Kjo zhvendosje, mes tjerash, u ndikua edhe nga normat më të larta të interesit në letrat me vlerë me afat më të gjatë maturimi krahasuar me ato me afat më të shkurtër maturimi.

Figura 35. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje




Burimi: BQK (2015)

Që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë në vitin 2012, shumica e ofertuar vazhdimisht ka tejkaluar shumën e shpallur në ankande prej Departamentit të Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave. Mirëpo, gjatë vitit 2014 krahasuar me vitin e kaluar

kemi zvogëlim të raportit në mes të shumës së ofertuar dhe asaj të kërkuar që ishte 1.4 herë më e lartë (1.9 herë më e lartë në 2013). Në këtë rënie ndikoi mosplotësimi i kërkesave të Departamentit të Thesarit nga akterët primar në bono të thesarit me maturim deri në 91 ditë dhe atyre me maturim deri në 182 ditë. Gjithashtu, rritja e përsheptuar e kreditimit nga bankat në 2014 si dhe ngadalësimi i depozitave (rënia e depozitave të afatizuar) si burim financimi, mund të kenë ndikuar në rënien e ofertës në letrat me vlerë nga bankat.

Figura 36. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2015)


Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë vitit 2014 ishte më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Rritja, mund të jetë ndikuar nga rënia e ofertës në letrat me vlerë. Po ashtu, në rritjen e normës mesatare të interesit ndikoi edhe fillimi i emetimit të letrave me vlerë me afat maturimi 2 vjeçar gjatë vitit 2014, të cilat u karakterizuan me norma më të larta të interesit (figura 36).

### Sektori i Jashtëm

Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë është përkeqësuar në nëntëmujorin e parë të vitit 2014

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 285.4 milionë euro në periudhën janar-shtator 2014, krahasuar me vlerën prej 207.2 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ky përkeqësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në mallra për 3.6 përqind, përderisa bilanci i llogarisë së tregtisë në shërbime u karakterizua me rritje prej 4.4 përqind. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2014, llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv (7.3 përqind), përderisa llogaria e të ardhurave dytësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv (2.7 përqind).

Figura 37. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro




Burimi: ASK (2015)

Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 2.2 miliard euro deri në dhjetor 2014, që paraqet një rritje prej 2.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 37). Gjithsej eksportet në dhjetor të vitit 2014 arritën vlerën 324.6 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.5 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të metaleve bazë, si kategori me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të vendit, rritjes së eksporteve të

makinerive dhe pajisjeve elektrike si dhe eksporteve të produkteve ushqimore.

Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, në dhjetor 2014, arriti në 2.5 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.6 përqind.

Figura 38. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, kategoria e mjeteve të transportit, si dhe importet e produkteve bimore, përderisa me rënie të vlerës së importuar u karakterizuan produktet minerale dhe produktet ushqimore. Si rezultat i rritjes së vlerës së eksporteve deri në dhjetor 2014, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 12.8 përqind, nga 12.0 përqind sa ishte në dhjetor 2013.

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve Kosovar jashtë vendit. Të hyrat nga kompensimi i punonjësve shënuan rënie në nëntëmujorin e parë të vitit 2014 në 154.1 milionë euro, nga 164.8 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 39. Struktur e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2015)

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në vend në nëntë muajt e parë të vitit 2014 arriti në 505.6 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.2 përqind (figura 38).

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve në nëntëmujorin e parë të vitit 2014 ishte 104.6 milionë euro, që paraqet një rënie të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 197.8 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie e IHD-ve mund t'i atribuohet kryesisht shitjes së aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë tek rezidentët kosovar si dhe shpërndarjes së superdividendës<sup>5</sup> së disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë (figura 39).

<sup>5</sup> Me superdividendë nënkuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë për periudhën përkatëse. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit të huaj aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

## **Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2014): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 8 TM3 2014, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

## **Referencat:**

BQK (2014):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2014):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në dhjetor 2014: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në dhjetor 2014: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në dhjetor 2014: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në dhjetor 2014: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në dhjetor 2014: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2014): Metal Prices database, qasur në dhjetor 2014.

FAO (2014): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në shtator 2014: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2014): Euribor Historical Rates, qasur në dhjetor 2014:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2014): World Economic Outlook: qasur në dhjetor 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2013	2014
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	1.8%	0.4%
Çmimet (fondi i periudhës)	0.6%	-0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,312.7	1,332.8
Shpenzimet (në milionë euro)	1,463.1	1,463.6
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-2.8%	-2.4%
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,231.3	4,543.2
prej të cilave: Bankat	3,059.3	3,186.8
Kredi	1,805.8	1,882.3
Depozita	2,449.0	2,537.5
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	11.1	9.2
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	2.4	1.1
Hendeku i normës së interesit	8.7	8.1
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	<b>Shtator 2013</b>	<b>Shtator 2014</b>
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-230.6	-290.9
prej të cilave: remitencat	454.6	505.8
Llogaria financiare	-70.0	-7.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	219.6	121.5
Investimet portfolio, net	227.0	112.6
Investimet tjera, net	-176.7	-39.2
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	414.9	396.7
Asetet	4,076.4	4,299.5
Detyrimet	3,661.5	3,902.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,584.8	1,690.0
Borxhi i jashtëm privat	1,197.0	1,306.6
Borxhi i jashtëm publik	387.8	383.4

Burimi:

1/ ASK (2015).

2/ MF (2015).

3/ BQK (2015).

